

PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË SHKENCAVE

1.METODA “PUNË NË DYSHE”

Në orën mësimore të lëndës Matematikë, klasa 7 B, me temë mësimore “Ushtrime me numrat dhjetorë” dhe me koncepte kryesore shumëzimin dhe pjestimin e numrave dhjetorë me 10, 100, 1000, metoda ‘punë në dyshe’ e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Mësuesja organizoi klasën në grupe dyshe dhe për secilin grup u ndanë detyrat përkatëse.
- Grupet u udhëzuan të mendonin dhe caktonin pyetjet që do i bënin shokut dhe për lehtësi ta shkruanin në fletoren e klasës. Secili grup punoi për detyrën, ku njëri nga nxënësit bënte pyetjen dhe tjetri i përgjigjej. Nxënësi që drejton pyetjen duhet edhe të përcaktojë nëse shoku është përgjigjur saktë ato jo. Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar maksimalisht.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës u vu re që secili nxënësi u angazhua maksimalisht dhe të gjithë punuan me përgjegjësi. Prezantimi i punës përmbushi rezultatin e të nxënësit që ishte vendosur për atë koncept të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në dyshe sepse ajo krijon një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Ermonela Harizi

ermonela.harizi@gea.edu.al

2.METODA “ZINXHIRI”

Në orën mësimore të lëndës Kimi, klasa IX-A, me temë mësimore ‘Vetitë kimike të grupit të parë’ e me koncept kryesor listimi i elementeve, njohja e vetive kimike dhe fizike të tyre, teknika e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit u përfshihen në të nxënë duke përdorur ‘metodën zinxhiri’. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Organizova klasën me pyetje personale që i drejtonin njëri-tjetrit.
- Nëse përgjigjet ishin të sakta, nxënësit vlerësoheshin nga unë për saktësinë e përgjigjes. Kjo bëhej njëri pas tjetrit në formën e një zinxhiri pyetje-përgjigje.

Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili nxënësi, por dhe unë si mësuese i kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 10 minuta.

Mësuesja: Armela Brahim

jeminiarmela4@gmail.com

3.METODA “KUTIA E PESHKUT”

Në orën mësimore të lëndës Biologji, klasa 7A, me temë mësimore Bakteret dhe me koncept kryesor mikrogjallesat, metoda ‘Kutia e peshkut’, e parashikuar në planin e orës

mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- U shpërndaj nxënësve nga një fletë dhe i udhëzoj që tek fleta të shkruajnë një pyetje në lidhje me mësimin e ditës. Të gjitha pyetjet do të vendosen në një kuti e cila quhet kutia e peshkut.
- Pasi të gjithë nxënësit shkruajnë pyetjet e tyre, cohet një nxënës dhe tërheq një fletë nga kutia. Lexon pyetjen dhe ia drejton një nxënësi tjetër. Nxënësi që jep përgjigjen, merr një letër tjetër nga kutia dhe ja jep një nxënësi tjetër.
- Loja do të vazhdojë derisa nxënësit t'ju përgjigjen të gjitha pyetjeve që ka kutia.
- Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili nxënës, por dhe unë si mësuese kam monitoruar veprimtarinë , e cila zgjati 10 minuta.
- Më pas, gjatë leximit të pyetjeve të secilit nxënës, u vu re që përgjigjet e tyre ishin mbresëlënëse dhe përmbushën arritjen e rezultatit të të nxënës që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën 'Kutia e peshkut', sepse ajo mundëson:

- Angazhimin e nxënësve
- Zhvillim të menduarit kritike
- Krijimin e një mjedisi bashkëpunues
- Nxitjen e krijimtarisë
- Reflektim dhe vlerësim

Mësuesja: Klesja Mukaj

klesja.mukaj@gea.edu.al

4.METODA “PUNË NË GRUPE”

Në orën mësimore të lëndës Fizikë, klasa e 6-të, me temë mësimore "Zgjidhje detyrash" dhe me koncept kryesor "Efektet e forcave mbi lëvizjen dhe formën e trupave", metoda/teknika e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen aktivisht në procesin e të nxënës. Zbatimi i metodës:

- Organizova klasën në 5 grupe me nga 4 veta. Çdo grup mori një detyrë specifike dhe u pajis me mjetet e nevojshme për zgjidhjen e saj: fletë të bardha, shënjes me ngjyra/markers. Për secilin grup u përcaktuan rolet, ku një nxënës ishte drejtues i grupit dhe pjesa tjetër ndihmës për përgatitjen e detyrës.
- Detyrat për grupet ishin si më poshtë: *Grupi 1*: Eksplorimi i forcave që shtojnë dhe tërheqin (p.sh. tërheqja e një lodre me fije peri dhe shtyrja e saj me dorë). Nxënësit duhej të identifikonin ndryshimet në lëvizje në varësi të forcës së ushtruar. *Grupi 2*: Vëzhgimi i ndikimit të forcës në deformimin e trupave (p.sh. shtypja e një gome lodre ose tërheqja e një

suste). Nxënësit duhej të shpjegojnë se si ndryshon forma e trupave nga veprimi i forcës. *Grupi 3:* Kërkimi i lidhjes midis forcës dhe drejtimit të lëvizjes (p.sh. shtyrja e një topi mbi tavolinë dhe vëzhgimi i ndalimit të tij për shkak të fërkimit). Nxënësit përgatitën një përfundim mbi rolin e forcave ndaluese. *Grupi 4:* Demonstrimi i ekuilibrit të forcave (p.sh. vendosja e një trupi të varur në një fije peri dhe vëzhgimi i tij në gjendje qetësie). Nxënësit duhej të shpjegojnë konceptin e forcave të barabarta dhe të kundërta. *Grupi 5:* Paraqitja skematike me vektorë e llojeve të ndryshme të forcave që veprojnë mbi trupa në çdo rast të mundshëm të detyrave të ngarkuara tek grupet e mësiperme.

- Çdo grup punoi për detyrën përkatëse për 10 minuta në mënyrë të pavarur, ndërkohë që unë, si mësues/e, monitorova procesin, ofrova mbështetje dhe bëra ndërhyrjet e nevojshme për t'i ndihmuar në rastet kur hasën vështirësi.
- Prezantimi:
Pas përfundimit të punës, çdo grup prezantoi për 5 minuta përfundimet dhe rezultatet e tyre përpara klasës duke përdorur fletët e bardha dhe shënjesit për të ilustruar përfundimet. Produktet e punës së nxënësve ishin mbresëlënëse, duke treguar se ata kishin kuptuar qartë konceptet e veprimit të forcave mbi trupa. Nxënësit demonstuan një aftësi të shtuar në
-Identifikimin e forcave të ndryshme (shtyrje, tërheqje, fërkim, elasticitet).
-Përshkrimin e efekteve të forcave mbi lëvizjen dhe formën e trupave.
-Aftësinë për të prezantuar dhe argumentuar në grup.

Përfundimi dhe rekomandimi:

Metoda e punës në grupe ndihmoi në krijimin e një atmosfere bashkëpunimi dhe përfshirjeje. Nxënësit ishin të angazhuar dhe motivuar gjatë gjithë orës. Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh këtë metodë, pasi ajo rrit ndërveprimin mes nxënësve dhe ndihmon në përvetësimin e koncepteve në mënyrë praktike dhe të qëndrueshme.

Mësuesja: Suela Dema

suela.dema@gea.edu.al

5.METODA “PUNË INDIVIDUALE”

Në orën mësimore të lëndës TIK, klasa V-b, me temë mësimore “Përpunimi i dokumentit ne Word” dhe me koncept kryesor përpunimin digjital të të dhënave, metoda ‘punë individuale’, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë.

- Gjatë kësaj ore mësimore nxënësit individualisht punuan në mënyrë të pavarur në kompjuter në lidhje me komandat e mësuara (Copy,Cut dhe Paste). Ata punuan të pavarur, duke u angazhuar secili/a nxënës/e, por dhe unë si mësues/e i kam monitoruar, kam ndërhyrë dhe lehtësuar secilin nxënës në veprimtarinë e tij, e cila zgjati 15 minuta.
- Më pas, gjatë prezantimit të punës të secilit u vu re se secili/a nxënës/e përdorte saktë komandat e mësuara (Copy,Cut dhe Paste) dhe u arrit nga të gjithë përmbushja e rezultatit të nxënësve që ishte vendosur për atë koncept të rëndësishëm të orës mësimore.

Ua sugjeroj kolegëve të mi të lëndës TIK, që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës individuale sepse ajo krijon një ndërveprim të efektshëm me kompjuterin dhe përfshirje të lartë në të nxënë.

Mësuesja: Valbona Xhabija

valbona.xhabija@gea.edu.al

6. METODA “STUHI MENDIMESH”

Në orën mësimore të lëndës “Biologji”, klasa e 10B, me temë mësimore “Fotosinteza dhe mjedisi” dhe me koncept kryesor *‘ndërvarësinë e fotosintezës nga frymëmarrja qelizore’* metoda e stuhisë së mendimeve, e parashikuar në planin e orës mësimore, më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Për të realizuar metodën “Stuhi mendimesh”, mësuesja drejtoi pyetje lidhur me procesin e fotosintezës për të nxitur kujtesën rreth njohurive që nxënësit kanë lidhur me këtë proces, si dhe për të bërë lidhjen me njohuritë e reja që do të merren gjatë orës mësimore.
- Gjatë zhvillimit të kësaj faze, mësuesja shkruan në tabelë përgjigjet e nxënësve dhe i përdor si bazë për ndërtimin e njohurive të reja.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh këtë metode, sepse ajo krijon një ndërveprim mes nxënësve dhe mësuesit, nxit diskutimin dhe shprehjen e lirë të nxënësve duke rritur përfshirjen e tyre në procesin mësimor.

Mësuesja: Irida Rapia

irida.rapia@gea.edu.al

7.METODA “PUNË NË GRUPE” DHE “LOJA ME FISHA”

Në orën mësimore të lëndës matematike, klasa 9-B, me temë mësimore “Përsëritje” dhe me temë “Mesataret aritmetike” metodat e ‘punës në grupe dhe loja me fishe’, të parashikuara në planin e orës mësimore mundësuan që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metodat u zbatuan në këtë mënyrë.

- Klasa u organizua në 4 grupe me nga 5 veta dhe për secilin grup u ndanë detyrat për drejtuesin dhe anëtarët e tij.
 - Grupi 1.Mbledhja dhe organizimi i të dhënave
 - Grupi 2.Seleksionimi dhe paraqitja grafike e të dhënave
 - Grupi 3.Analizimi dhe gjetja e mesatareve aritmetike e të dhënave
 - Grupi 4.Përforcimi i njohurive me lojë me fishe duke bërë gati paraprakisht konceptet kryesore në fishe dhe në një karton, në të cilat do ngjiten shembujt përbri koncepteve ose përkufizimeve kryesore.
- Grupi 1 përdori anketimin, intervistën e drejtpërdrejtë dhe të dhëna nga database e një farmacie, ku intervistuan dhe morën të dhënat në lidhje me ilacet më të shitura në një farmaci gjatë një periudhe një mujore.Kjo punë ketij grupi i krijoi idenë se si është të punosh në fushën e statistikës në fazën e grumbullimit të të dhënave.

- Grupi 2 mori të dhënat nga grupi i parë, i seleksionoi si të dhëna diskrete apo të vazhduara dhe përdori tabela ose diagram me shtylla të punuara në excel për paraqitjen e të dhënave. U shpjeguan vështirësitë që u hasën gjatë seleksionimit dhe organizimit të të dhënave.
- Grupi 3 gjeti mesataren aritmetike, modën, mesoren, amplitudën dhe mesataren aritmetike të të dhënave. U diskutuan konkluzionet që mund të nxjerrin për situatën e studiuar në varësi të vlerave të mesatareve.
- Grupi 4 kishte përgatitur paraprakisht fisha me të gjitha konceptet e kapitullit dhe shembuj të dhënash diskrete apo të vazhduara. Përforcimi i njohurive organizohet në formë loje, ku secili nxënës zgjedh një fishe dhe e ngjit përbri konceptit kryesor në karton ose përbri përkufizimit nëse është përkufizim i saktë.

Të gjithë nxënësit u përfshinë dhe rikujtuan dhe mësuan konceptet kryesore. Të katër grupet prezantuan punën e tyre si dhe vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së materialeve për orën e mësimit. Ora u pëlqye shumë nga të gjithë dhe u komentua pozitivisht për rëndësinë e praktikës së të nxënësve të koncepteve.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e punës në grupe dhe punës kërkimore paraprake me anë të fishës, sepse ato krijojnë një ndërveprim dhe përfshirje të lartë në të nxënësi si dhe e vendosin nxënësin në pozicionin e ekspertit dhe hulumtuesit.

Mësuesja: Detjona Cekrezi

detjona.ckrezi@gea.edu.al